

## FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE E HËNË 23 TETOR 2021

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Po e nis fjalimin e parë në foltoren e këtij Kuvendi me një falënderim për të gjithë qytetarët e qarkut të Korçës, të cilët zgjedhën dhe votuan Partinë Socialiste në zgjedhjet e 25 prillit. Populli shqiptar është i ditur dhe di të zgjedhë alternativën më të mirë, duke ia besuar drejtimin vendit edhe për 4 vjetët e ardhshëm Partisë Socialiste. Ky është një motiv më shumë për ne për të dhënë shembullin e një institucioni ligjvënës në këtë vend dhe më vjen keq, marr shkas edhe nga seancat e kaluara, që gjendem në kushtet që të kthej vëmendjen tuaj, veçanërisht të zonjave opozitare, që të kemi më shumë respekt për veten dhe koleget. Çfarë shembulli do t'u japim ne fëmijëve tanë? Çfarë modeli drejtimi do t'u japim institucioneve që vijnë pas nesh? Jo, kurrësesi, këto nuk mund të shkojnë bashkë. Së dyti, sot çështja më sensistive është mbrojtja e qytetarëve dhe e shëndetit të tyre. Përtej të majtës dhe të djathtës, do t'u bëj një thirrje të gjithë qytetarëve të vaksinohen, sepse virusi nuk zgjedh. Po kaloj te rendi i ditës. Në kuadër të "Javës së gjelbër", kam pasur kënaqësinë të jem e angazhuar plotësisht me qytetarët e Bashkisë së Korçës për të arritur qëllimin tonë të përbashkët: për të forcuar bazën e demokracisë, fuqizimin e pjesëmarrjes dhe rritjen e besimit të zgjedhësit. Hapja e zyrave të para të komunikimit me zgjedhësit në Shqipëri, mbështetur nga prezenca e OSBE-së dhe financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim, në kuadër të projektit "Ndërtimi i urave lidhëse ndërmjet parlamentit dhe shoqërisë civile", na ka ndihmuar për të evidentuar problematikat dhe ka siguruar një vend, ku qytetarë të ndryshëm, duke përfshirë këtu të rinjtë, gratë, grupet në nevojë, mund të gjejnë informacion dhe të angazhohen në mënyrë aktive në procesin ligjvënës. Duke qenë se një nga shqetësimet kryesore të shprehur nga qytetarët gjatë takimeve pranë zyrës së komunikimit me zgjedhësit, por edhe në zonat e vendbanimit të tyre, ka qenë përfundimi i rrugës Qukës-Qafë Plloçë, si dhe ndërtimi i rrugës Qukës-Elbasan. Si e anëtare e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave së bashku me kolegët e tjerë të opozitës, por edhe të pozitës do të angazhohemi maksimalisht që në buxhetin e vitit 2021, që do të miratojmë së shpejti, të planifikohet fondi për përfundimin rrugës Qukës-Qafë Plloçë, si dhe ndërtimi i rrugës Qukës-Elbasan, rrugë këto kaq të rëndësishme për Juglindjen e Shqipërisë. Përmirësimi i këtij poli në infrastrukturën rrugore kombëtare dhe rajonale, përveç shkurtimit të distancave kilometrike dhe lehtësirave në qarkullim, do të sjellë përfitime ekonomike, nxitje të turizmit, shkurtim të kohës për mallrat e importit që do të arrijnë në destinacion, duke sjellë rrjedhimisht përfitime për biznesin që operon në këtë fushë. Së dyti, në takimin me prindër të fëmijëve me aftësi ndryshe dhe me aftësi të kufizuara shqetësim dhe kërkesë e tyre ishin mësuesit ndihmës në shkolla për këta fëmijë. Për këtë ka dy probleme: Problemi i parë është numri i tyre, sepse praktikisht ka më pak mësues mbështetës në shkolla, pavarësisht se dispozitat ligjore ekzistojnë, pra një mësues në çdo klasë, dhe koha që do u duhet të qëndrojnë në klasë këta fëmijë është më e vogël për arsye të mungesës së mësueseve. Problemi i dytë, jo më pak i rëndësishëm, është trajnimi i mësuesve mbështetës. Një pjesë e tyre janë të patrajnuar dhe nuk ofrojnë

shërbime të specializuara, përveç prezencës fizike në klasa burimore. Nisur nga problematikat e fëmijëve me aftësi ndryshe dhe aftësi të kufizuara, duhet të ketë trajnime të mësuesve që ofrojnë këtë lloj shërbimi për shkak të vështirësive që fëmijët kanë për t'u integruar në sistemin arsimor. Këto problematika i adresuam gjatë dëgjësës me ministren e Arsimit, zonjën Kushi, dhe më vjen mirë të dëgjoj se ministria ka filluar zbatimin e një projekti, në kuadër të të cilit mësuesit mbështetës po trajnohen dhe po specializohen në mënyrë të vazhdueshme për t'i ardhur në ndihmë kësaj kategorie fëmijësh. Ky është një proces që ka filluar dhe do të vijojë për të profilizuar mësuesit mbështetës, duke bashkërenduar edhe me planifikimin buxhetor për vitin 2022, që nevojitet për këtë shërbim. Kërkesa e tretë lidhet me nevojën e qytetarëve për banesa sociale. Kërkesat e shumta për strehim social janë më të mëdha se mundësitë që kanë organet e pushtetit vendor për të përmbushur nevojat e qytetarëve. Duke qenë se jemi në prag të hartimit të projektbuxhetit të vitit 2022, kërkohet që qeveria të rrisë fondet buxhetore për këtë vit për bashkitë, me qëllim rritjen e numrit të banesave sociale. Më vjen mirë që një shqetësim drejtuar zyrës së Komunikimit të Zgjedhësve të Bashkisë Korçë gjeti zgjidhje falë bashkëpunimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Bashkisë Korçë, duke i hapur rrugë privatizimit të banesave të strehimit të ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banësive për 28 familje me status social: invalidë, ish-pronarë dhe ish- të përndjekur politikë. Për ta mbyllur fjalën time, ftoj të gjithë qytetarët t'u bashkohen iniciativave të ndryshme ligjvënëse, duke i përcjellë ato drejtpërdrejt në zonat tona të komunikimit. Faleminderit!